

Nr . .....Prot.

Tiranë, me \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje uniforma pune për personelin e shoqërise OSHIS sh.a”.

**KODI SIPAS FJALORIT TË PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):** 18100000-0  
Uniforma.

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 11,637,866.67 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lek pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sh.a., ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a) Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b) Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, nenit 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilat parashikohet se:

Neni 82, i LPP-së, pika 1: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP-së: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë**

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet.**

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” dhe pikën 1 të nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.... Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij

kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet se: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit të prokuruar, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

## **2.3 Kapaciteti Teknik**

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, ku vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës**, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa për paraqitjen e dëshmive që vërtetojnë realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme është vendosur në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 40 të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar. Përmes këtij kriteri Autoriteti Kontraktor synon të verifikojë përvojën e operatorëve ekonomikë në realizimin e kontratave të ngjashme me objektin e prokurimit, me qëllim garantimin e përmbushjes me cilësi dhe në afat të detyrimeve kontraktore. Furnizimi me uniforma pune kërkon jo vetëm disponimin e kapaciteteve financiare dhe logjistike, por edhe eksperiencë të mëparshme në furnizimin e mallrave të kësaj natyre, për të garantuar përputhshmërinë me specifikimet teknike, afatet e furnizimit dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Vlera e kërkuar e kontratave të ngjashme, në masën jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet, është përcaktuar në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik dhe vlerësohet proporcionale me objektin, natyrën dhe përmasat e kontratës. Kjo

*përqindje nuk kufizon konkurrencën, por siguron që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të kenë eksperiencën minimale të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa për paraqitjen e vërtetimeve të lëshuara nga entet publike ose faturave tatimore të shitjes, sipas rastit, është vendosur me qëllim verifikimin objektiv të përvojës së deklaruar nga operatorët ekonomikë, si dhe për të garantuar që kontratat e ngjashme të jenë realizuar realisht dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikimin ISO 9001:2015, ose ekuivalente, për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë dhe ISO 14001:2015, ose ekuivalente, për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 dhe nenit 79 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku parashikohet e drejta e autoritetit kontraktor për të kërkuar certifikata të cilësisë dhe standardeve të menaxhimit si pjesë e kritereve të kualifikimit, me qëllim verifikimin e kapaciteteve teknike dhe organizative të operatorëve ekonomikë.*

*Këto certifikime ndërkombëtare përbëjnë një garanci të njohur për funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë, menaxhimit mjedisor, duke reflektuar aftësinë e operatorit ekonomik për të organizuar dhe realizuar procese prodhimi dhe furnizimi në mënyrë të kontrolluar, të standardizuar dhe të dokumentuar.*

*Duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, i cili konsiston në furnizimin me uniforma pune për personelin e shoqërisë, është e domosdoshme që produktet të prodhohen dhe furnizohen sipas standardeve të njohura ndërkombëtare, me qëllim garantimin e cilësisë së materialeve, qëndrueshmërisë së produkteve në përdorim të përditshëm, si dhe sigurisë së përdoruesve gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.*

*ISO 9001:2015 garanton ekzistencën e një sistemi efektiv të menaxhimit të cilësisë, që siguron kontroll të vazhdueshëm të proceseve të prodhimit dhe furnizimit. ISO 14001:2015 siguron që aktiviteti i operatorit ekonomik zhvillohet në përputhje me standardet e mbrojtjes së mjedisit, duke minimizuar ndikimet negative në mjedis gjatë proceseve të prodhimit të tekstileve.*

*Këto kërkesa janë vendosur në mënyrë proporcionale dhe jodiskriminuese, pasi pranohen edhe certifikime ekuivalente të lëshuara nga organe të akredituara, dhe nuk kufizojnë konkurrencën, por shërbejnë për të garantuar realizimin e kontratës me cilësinë e kërkuar, brenda afateve dhe standardeve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, si dhe për mbrojtjen e interesit publik dhe sigurisë së përdoruesve të uniformave.*

**2.3.3** Ofertuesi duhet të paraqesë Çertifikatë OEKO-TEX (Standardi 100, Klasa e Prodhuesit 2) ose ekuivalente, të vlefshme, të produktit ose të prodhuesit të lëndës së parë të artikujve tekstilë objekt prokurimi, për të vërtetuar se lëndët e para të artikujve të ofruar nuk kanë substanca të dëmshme për shëndetin dhe janë në përputhje me normativat e specifikuar të certifikimit OEKO-TEX ose ekuivalente. Në rastin kur lëndët e para sigurohen nga prodhues të ndryshëm, çertifikata ose dokumenti ekuivalent me të, duhet të paraqitet për secilin nga prodhuesit. Për këtë OE pjesëmarrës

duhet të paraqesë një autorizim nga prodhuesi i produktit ose prodhuesi i lëndës së parë ku të bëhet lidhja midis prodhuesit dhe OE/distributorit të autorizuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë paraqitjen e certifikatave të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit për të provuar se mallrat objekt prokurimi përmbushin standardet e kërkuara të cilësisë dhe sigurisë.

Kjo kërkesë është vendosur me qëllim garantimin që lëndët e para tekstile të përdorura në prodhimin e uniformave të punës nuk përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e përdoruesve dhe janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë për produktet tekstile. Duke qenë se uniformat do të përdoren në mënyrë të vazhdueshme nga personeli i shoqërisë, autoriteti kontraktor vlerëson të domosdoshme garantimin e cilësisë, sigurisë dhe përshtatshmërisë së materialeve që vijnë në kontakt të drejtpërdrejtë me trupin e përdoruesit. Certifikimi OEKO-TEX Standard 100 ose ekuivalent përbën një garanci të pavarur që produktet tekstile janë testuar për praninë e substancave të dëmshme dhe përmbushin kërkesat e sigurisë për përdorim njerëzor. Për rrjedhojë, kjo kërkesë është në përpjesëtim me objektin e prokurimit, nuk kufizon konkurrencën, pasi pranohet edhe çdo certifikim ekuivalent, dhe shërben për mbrojtjen e shëndetit të përdoruesve si dhe për sigurimin e cilësisë së mallrave që do të furnizohen.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues, ose tregëtues i autorizuar nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për artikujt objekt prokurimi. Në rast se, ofertuesi nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave dhe të vërtetohet lidhja midis tyre. Operatori ekonomik ofertues në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të ketë të përcaktuar të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, email, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë lëshuar për objektin konkret të prokurimit dhe për llogari të Autoriteti Kontraktor.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë prodhuesit e të gjitha mallrave objekt prokurimi me të dhënat e kontaktit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, sipas të cilave autoriteti kontraktor mund të kërkojë dokumentacion që provon kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit ekonomik për realizimin e kontratës.

Kjo kërkesë është vendosur me qëllim garantimin e origjinës, cilësisë, gjurmueshmërisë dhe disponueshmërisë së mallrave objekt prokurimi. Duke qenë se objekti i kontratës lidhet me furnizimin e uniformave të punës për personelin e shoqërisë, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të sigurohet që operatori ekonomik të ketë akses të ligjshëm dhe të garantuar tek prodhuesi ose kanali zyrtar i furnizimit.

Paraqitja e autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar shërben për të vërtetuar se operatori ekonomik është i autorizuar të furnizojë mallrat e ofruara, si dhe garanton që produktet do të jenë origjinale, në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, kjo kërkesë minimizon rrezikun e furnizimit

*me produkte të paidentifikuara në origjinë, me cilësi të pakontrolluar ose që nuk plotësojnë kërkesat teknike të autoritetit kontraktor.*

*Për rrjedhojë, kjo kërkesë vlerësohet si proporcionale me objektin e prokurimit, e lidhur drejtpërdrejt me realizimin me sukses të kontratës dhe në funksion të mbrojtjes së interesave të autoritetit kontraktor.*

**2.3.5** Me qëllim për të krahasuar përputhshmërinë me specifikimet teknike të kërkuara, në datën e hapjes së ofertave operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë nga një mostër fizike për secilin nga artikujt (produkt të gatshëm) që do të prokurohen që përfshin të gjitha detajet, llojin e materialit dhe pjesëve përbërëse të tyre, punimin dhe përmasat e caktuara në specifikimet teknike.

Mostrat e paraqitura duhet të kenë të trupëzuar një etiketë të qepur, e cila të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, Objektin e Porcedurës për të cilin oferton, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit të mostrave të sjella me përputhshmërinë e specifikimeve të kërkuara dhe të kryejë analizat e nevojshme laboratorike nëse do të shihet e arsyeshme.

*Mungesa e mostrës është kusht s’kualifikues.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 6, shkronja “a” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Udhëzimin Nr. 3, datë 12.4.2022, të Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi procesin e adminitrimit të motrave të paraqitura nga operatorët ekonomik”, sipas të cilit autoriteti kontraktor mund të kërkojë mostra të mallrave që do të prokurohen, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Kërkesa për paraqitjen e mostrave është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e veçantë të objektit të prokurimit, që konsiston në furnizimin me uniforma pune për personelin e shoqërisë, i cili punon në ambiente që kërkojnë kushte të larta pastërtie (steriler) dhe kryen një shërbim të rëndësishëm që ndikon në shëndetin e pavientëve në qendrat spitalore. Mostrat janë të nevojshme për të mundësuar verifikimin fizik të karakteristikave të artikujve të ofertuar, si cilësia e materialit, përbërja tekstile, ngjyra, qepjet, punimi, aksesoret, etiketimi, përmasat dhe elementët e tjerë teknikë të përcaktuar në specifikimet teknike.

Paraqitja e mostrave i mundëson autoritetit kontraktor të kryejë një vlerësim objektiv të produkteve të ofruara dhe të sigurohet që mallrat e ofertuara përmbushin kërkesat funksionale dhe cilësore të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, kjo kërkesë minimizon rrezikun e furnizimit me artikuj që nuk përputhen me specifikimet teknike ose që nuk garantojnë cilësinë e kërkuar për përdorim të përditshëm nga personeli.

**2.3.6** Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (Raporte testi/analiza) të lendeve të para të produkteve, për artikujt “Uniformë pune për operatorët e centralit të sterilizimit dhe sallat operatore”, “Uniformë pune për përgjegjesat e centralit dhe të sallës operatore”, “Uniformat për sanitarët nëpër centralet e sterilizimit”, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të kërkuara.

(Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndën e parë që shoqëron atë dhe ajo e fletë-analizës duhet të jenë detyruesisht të njëjta).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 dhe nenit 79 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, sipas të cilave autoriteti kontraktor mund të kërkojë dokumentacion teknik dhe dëshmi për standardet e cilësisë së mallrave objekt prokurimi, për të garantuar përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike.

Kjo kërkesë është vendosur me qëllim garantimin e cilësisë, sigurisë dhe qëndrueshmërisë së materialeve tekstile të përdorura në prodhimin e uniformave të punës. Duke qenë se uniformat do të përdoren në mënyrë të vazhdueshme nga personeli, është e domosdoshme që lëndët e para të jenë të testuara dhe të certifikuara nga laboratorë të akredituar, në mënyrë që të sigurohet se ato përmbushin parametrat teknikë të kërkuar dhe nuk përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e përdoruesve dhe për shëndetin e pacientëve që marrin shërbime në spitale me instrumentat që sterilizohen.

Paraqitja e raporteve të testimit përbën një garanci objektive mbi cilësinë dhe përputhshmërinë e materialeve me standardet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare, duke mundësuar një vlerësim të saktë dhe të verifikueshëm të ofertave.

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/fragmente të katalogut ose skedat teknike të prodhuesit për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Këto dokumente duhet të përmbajnë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 6, shkronja “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, sipas të cilave autoriteti kontraktor mund të kërkojë dokumentacion teknik për verifikimin e përputhshmërisë së mallrave të ofruara me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Kjo kërkesë është vendosur me qëllim verifikimin e karakteristikave teknike të artikujve të ofruar, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet se uniformat e punës për personelin përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike, si materiali, përbërja tekstile, gramatura, ngjyra, qëndrueshmëria dhe elementët e tjerë funksionalë.

Paraqitja e katalogëve ose skedave teknike mundëson një vlerësim objektiv dhe të krahasueshëm të ofertave, duke garantuar transparencë në procesin e vlerësimit dhe duke shmangur çdo paqartësi lidhur me produktet e ofruara. Gjithashtu, kjo kërkesë siguron që mallrat e ofertuar janë të identifikueshme, të standardizuara dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor.

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë/deklaratë konformiteti CE për artikujt objekt prokurimi referuar specifikimeve teknike.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 dhe nenit 79 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku parashikohet e drejta e autoritetit kontraktor për të kërkuar dokumentacion që vërteton përputhshmërinë e mallrave me standardet dhe kërkesat teknike të aplikueshme.

Kjo kërkesë është vendosur me qëllim garantimin që artikujt objekt prokurimi përmbushin standardet përkatëse të sigurisë dhe cilësisë të zbatueshme në tregun europian, në rastet kur për produktet tekstile kërkohet ose aplikohet markimi CE ose dokumentacion ekuivalent i konformitetit.

Paraqitja e deklaratës ose certifikatës së konformitetit CE shërben si garanci shitesë për autoritetin kontraktor se produktet e ofruara janë në përputhje me kërkesat teknike dhe standardet e sigurisë të njohura, duke siguruar cilësi, besueshmëri dhe gjurmueshmëri të mallrave të furnizuara.

Kjo kërkesë është proporcionale me objektin e prokurimit, nuk kufizon konkurrencën dhe synon rritjen e nivelit të sigurisë dhe cilësisë së produkteve që do të përdoren nga personeli i shoqërisë.

**2.3.9** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 10 punonjës për 3 muajt e fundit, nga data e hapjes së ofertave. Për plotësimin e kësaj kërkesë, operatori ekonomik duhet të dorëzojë një vërtetim për numrin e punonjësve të lëshuar nga Administrata Tatimore që vërteton se subjekti ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për 3 muajt e fundit, shoqëruar me listëpagesën e dorëzuar pranë organeve tatimore për 3 muajt e fundit.

**Sqarim:** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë personelin dhe kapacitetet teknike të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë është vendosur me qëllim verifikimin e kapacitetit organizativ dhe operativ të operatorit ekonomik për realizimin e kontratës objekt prokurimi. Duke marrë në konsideratë natyrën e kontratës, e cila konsiston në prodhimin dhe furnizimin e uniformave të punës për personelin e shoqërisë, është e nevojshme që operatori ekonomik të disponojë një numër minimal punonjësish për të garantuar realizimin në kohë, në sasi dhe me cilësinë e kërkuar të mallrave.

Kriteri për numrin minimal të punonjësve siguron që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm njerëzor për të përmbushur detyrimet kontraktuale, duke minimizuar rrezikun e vonesave apo mosrealizimit të kontratës dhe duke garantuar që furnizimi kryhet sipas afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Është kërkuar ky numër punonjësish duke ju referuar sasisë së artikujve objket porkuirmi dhe kohës së kryerjes së këtij furnizimi.

**2.3.10** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në funksion të përmbushjes me sukses të kontrates duhet të vërtetojnë se disponojnë personel të kualifikuar, si më poshtë:

1. Të paktën një Inxhinier Tekstil.

2. Të paktën një Modelist.

Për sa më sipër operatorët ekonomik duhet të paraqesin:

Për Inxhinierin Tekstil:

Kopje të diplomës;

Kontratën e punës (te vlefshme);

Kopje të librezës së punës;

Deklarimin e profilit të personelit të kërkuar në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit;

Listapagesat sipas formularit E-Sig 025/a për periudhën e kërkuar.

Për punonjësin Modelist:

Dokument që të vertetojnë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi

profesional/certifikate/diplome), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licensuara, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.

Kontratën e punës (te vlefshme);

Kopje të librezës së punës;

Deklarimin e profilit të personelit të kërkuar në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit;

Listapagesat sipas formularit E-Sig 025/a për periudhën e kërkuar.

Personeli i kualifikuar duhet të jetë pjesë e përvojës së ofertuesit dhe për këtë OE duhet të dëshmojnë se kanë patur në listapagesat e shoqërisë për një periudhë jo më pak se tre muaj nga data e hapjes së ofertave, specialistët e sipërcituar.

**Sqarim:** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 5, shkronja "b" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, ku parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë personelin teknik dhe stafin kryesor të nevojshëm për realizimin e kontratës.

Kjo kërkesë është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën specifike të objektit të prokurimit, i cili konsiston në furnizimin e uniformave të punës për personelin e shoqërisë. Për shkak të nevojës për garantimin e cilësisë së materialeve, saktësisë së modelimit, përputhshmërisë me specifikimet teknike dhe standardizimit të përmasave, është e domosdoshme angazhimi i stafit të kualifikuar profesionalisht.

Inxhinieri i tekstilit siguron kontrollin dhe vlerësimin teknik të materialeve dhe proceseve të prodhimit, ndërsa modelisti garanton realizimin korrekt të modeleve, përmasave dhe dizajneve të uniformave në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Prania e këtyre specialistëve është thelbësore për sigurimin e cilësisë, uniformitetit dhe funksionalitetit të produkteve të furnizuara.

**2.3.11** Operatori Ekonomik Ofertues duhet te provoje se disponon minimalisht **10 makina qepese** ne pronesi ose me kontrate qeraje/huaperdorje, per kete duhet te paraqese dokumentacionin qe provon pronesine si kontrate shitblerje, dhurimi, fatura tatimore, deklarate zhdoganimit ose kontrate qeraje/huaperdorje.

**Sqarim:** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku parashikohet e drejta e autoritetit kontraktor për të kërkuar kapacitetet teknike dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e kontratës.

*Kjo kërkesë është vendosur me qëllim verifikimin e kapacitetit prodhues të operatorit ekonomik për realizimin e kontratës objekt prokurimi, e cila konsiston në prodhimin dhe furnizimin e uniformave të punës për personelin e shoqërisë. Disponimi i një numri minimal makinash qepëse garanton që operatori ekonomik ka infrastrukturën e nevojshme teknike për të përmbushur sasitë e kërkuara dhe afatet kohore të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

*Kriteri i vendosur është proporcional me volumin e kontratës, kohëzgjatjen e saj dhe shërben për të minimizuar rrezikun e vonesave në prodhim dhe furnizim, duke siguruar realizimin e kontratës me cilësinë dhe afatet e kërkuara nga autoriteti kontraktor.*

**2.3.12** Operatori Ekonomik Ofertues duhet te provoje se disponon minimalisht **1 makine transporti** ne pronesi ose me kontrate qeraje/huaperdorje, per kete duhet te paraqese dokumentacionin perkates sipas legjislacionit ne fuqi.

Mjeti i transportit duhet te jete i pajisur me dokumentacion perkates sipas legjislacionit ne fuqi (certifikat pronesie, leje qarkullimi, siguracion mjeti (te vlefshme), certifikate e kontrollit teknik te mjetit (te vlefshme), taksat vjetore).

Ne rastin kur mjeti i transportit eshte me qera/huaperdorje duhet te paraqitet gjithashtu kontratë qeraje/huaperdorje noteriale për gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

**Sqarim:** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

**Argumentimi:** Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë minimalisht 1 (një) mjet transporti në pronësi ose nëpërmjet kontratës së qirasë/huapërdorjes është vendosur në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, dhe nenit 41 të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, me qëllim verifikimin e kapaciteteve teknike dhe logjistike të operatorëve ekonomikë për realizimin e kontratës.

Objekti i prokurimit konsiston në furnizimin me uniforma pune për personelin e shoqërisë OSHIS sh.a., çka kërkon që operatori ekonomik të ketë mundësinë reale për transportimin, shpërndarjen dhe dorëzimin e mallrave në përputhje me afatet dhe kushtet e kontratës. Për këtë arsye, disponimi i të paktën një mjeti transporti përbën një kërkesë minimale, të domosdoshme dhe proporcionale me natyrën e kontratës.

Kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit përkatës të mjetit të transportit (certifikatë pronësie, leje qarkullimi, siguracion të vlefshëm, certifikatë të kontrollit teknik të vlefshme dhe dokumentacion mbi pagesën e detyrimeve ligjore) synon të garantojë se mjeti është i ligjshëm dhe i përshtatshëm për t’u përdorur gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës.

Në rastet kur mjeti disponohet nëpërmjet kontratës së qirasë ose huapërdorjes, kërkesa për paraqitjen e kontratës noteriale për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës ka për qëllim të sigurojë disponueshmërinë e pandërprerë të mjetit dhe të minimizojë rrezikun e mosrealizimit të furnizimit për shkaqe që lidhen me mungesën e kapaciteteve logjistike.

Gjithashtu, kërkesa që në fazën e ofertimit përmbushja e këtij kriteri të deklarohet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit është në përputhje me pikën 1 të nenit 26 të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar. Dokumentacioni provues do të kërkohej vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit, duke respektuar parimet e thjeshtimit të procedurave, uljes së barrës administrative dhe rritjes së efikasitetit të procesit të prokurimit publik.

**2.3.13** Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të mallit në adresën e autoriteti kontraktor përfitues.

**Argumentimi:** Kërkesa që operatori ekonomik pjesëmarrës të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e transportit të mallrave në adresën e Autoritetit Kontraktor është vendosur në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, dhe nenit 40 të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

Duke qenë se objekti i kontratës lidhet me furnizimin me uniforma pune për personelin e shoqërisë OSHIS sh.a., transporti dhe dorëzimi i mallrave në vendin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor përbëjnë pjesë integrale të realizimit të kontratës. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor e vlerëson të nevojshme marrjen e një angazhimi formal nga operatori ekonomik se do të sigurojë transportin dhe dorëzimin e mallrave me shpenzimet dhe përgjegjësinë e tij.

Kjo kërkesë synon të garantojë që operatori ekonomik është në dijeni të detyrimeve që rrjedhin nga kontrata dhe disponon kapacitetet e nevojshme organizative dhe logjistike për përmbushjen e tyre, duke shmangur vonesa apo problematika gjatë fazës së ekzekutimit të kontratës.

**2.3.14** Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se garancia e mallrave do të jete 12 muaj.

**Argumentimi:** *Kërkesa që operatori ekonomik pjesëmarrës të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të garantojë mallrat objekt prokurimi për një periudhë prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të parimit të mbrojtjes së interesit publik dhe sigurimit të cilësisë së mallrave të furnizuara.*

*Duke qenë se objekti i prokurimit konsiston në furnizimin me uniforma pune për personelin e shoqërisë OSHIS sh.a., Autoriteti Kontraktor ka interes të ligjshëm të sigurohet që mallrat e furnizuara të jenë në përputhje me specifikimet teknike, të kenë cilësinë e kërkuar dhe të ruajnë karakteristikat e tyre gjatë përdorimit normal për një periudhë të arsyeshme kohore.*

*Periudha e garancisë prej 12 muajsh është vlerësuar si një afat i përshtatshëm dhe proporcional me natyrën e mallrave që prokurohen, duke i mundësuar Autoritetit Kontraktor të kërkojë zëvendësimin ose korrigjimin e çdo defekti, mangësie apo moskonformiteti që mund të konstatohet gjatë kësaj periudhe dhe që nuk vjen si pasojë e përdorimit jo të rregullt të tyre.*

*Kërkesa për paraqitjen e deklaratës së garancisë nuk krijon kufizime për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, por synon të sigurojë angazhimin e tyre për furnizimin e mallrave cilësore dhe për përmbushjen e detyrimeve pas dorëzimit të tyre, në funksion të realizimit me sukses të kontratës dhe mbrojtjes së interesave të Autoritetit Kontraktor.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të njehsuara me origjinalin. Rastet e mosparaqitjes së dokumenteve, paraqitjes së dokumenteve të rreme ose të pasakta konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me nenin 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë pjesë e pandarë e DST

*Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.*

Transporti dhe vendosja e mallrave objekt prokurimi në ambjentet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor do të realizohet nga operatori ekonomik fitues.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**